# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475382**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Diplomacia e pandave” rikthehet në SHBA! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/diplomacia-e-pandave-rikthehet-ne-shba-i588877` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 08:10:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 09:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1cc274d6b9a923618c6f4ba5ff9f8cedd584faca633e109316d9fca4fa01fb37` |
| TEKSTI | `3d5090c91a2dd2a2ad1da9aa92b59fe4392901985fb6664ef9d9a01de8c5c6d7` |
| PAMJA | `94258a61153187f891892ea64c731e1191212a403cb80ed70a9ce8df64d21072` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c9a29d9aa8d1b70bce0007dee4e4e2a16e0d0d327bc65aa22370fa43b7858272` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c9a29d9aa8d1b70bce0007dee4e4e2a16e0d0d327bc65aa22370fa43b7858272`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Diplomacia e pandave” rikthehet në SHBA!

TemA
28 Shtator 2026, 11:10Bota TEMA



Dy panda gjigante nga Kina kanë mbërritur në Kopshtin Zoologjik të Atlantës, ku do të qëndrojnë për 10 vjet në kuadër të një marrëveshjeje për ruajtjen dhe shumimin e species.

6-vjeçari Ping Ping dhe 5-vjeçarja Fu Shuang udhëtuan rreth 8 mijë milje nga Kina drejt SHBA-së.

Ata u transportuan me një avion, të shoqëruar me bambu të freskët, ujë dhe ushqimet e tyre të preferuara.

Përpara udhëtimit, pandat iu nënshtruan një periudhe karantine dhe u trajnuan për të qëndruar në arkat e transportit dhe për t'u përshtatur me zhurmat e udhëtimit.

Megjithatë, vizitorët nuk do të mund t'i shohin menjëherë.

Ping Ping dhe Fu Shuang do të qëndrojnë rreth një muaj në karantinë, përpara se të prezantohen me publikun.

Ardhja e tyre në Atlanta ka edhe një rëndësi për programet e ruajtjes së pandave.

Kafshët konsiderohen ende të cenueshme dhe riprodhimi në robëri është veçanërisht i vështirë, pasi femrat janë pjellore vetëm për një periudhë shumë të shkurtër çdo vit.

Ping Ping dhe Fu Shuang janë përzgjedhur për moshën, shëndetin, karakteristikat gjenetike dhe personalitetin e tyre, me shpresën se do të çiftëzohen natyrshëm.

Dy pandat janë gjithashtu pjesë e asaj që njihet si “diplomacia e pandave”, përmes së cilës Kina ka përdorur prej dekadash huazimin e pandave si një formë të marrëdhënieve diplomatike me vende të tjera.

Sipas marrëveshjes, pandat dhe pasardhësit e tyre do të mbeten pronë e Kinës dhe do të kthehen atje në të ardhmen.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Një javë pa ushqim dhe karburant, shpëtohen 260 emigrantë në Atlantik

10:00 Bota

[Zbuloi transferimin sekret të dy ushtarëve koreano-veriorë, Koreja e Jugut i kërkon llogari Ukrainës: Kërkoni falje!]

09:50 Bota

SHBA tërhiqet nga Iraku, forcat amerikane largohen plotësisht nga vendi

09:40 Bota / 1 koment

Nafta rritet ndërsa bisedimet e paqes SHBA-Iran hecin përpara


Nafta rritet ndërsa bisedimet e paqes SHBA-Iran hasin ngërç

09:30 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.